




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Ligjit 02/L-109 për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse, Vendimit të Kuvendit të Komunës për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e klubeve sportive 15Nr.400-16852 i datës 17.04.2020, nenit 2 paragrafi 7 i Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve si dhe Rekomandimit të Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport 1-400-20523 të datës 02.06.2020, Kryetari i Komunes nxjerr:

VENDIM

PËR EKZEKUTIMIN E PAGESËS PËR SUBVENCIONIMIN E KLUBEVE SPORTIVE

Neni 1

OBLIGOHET, Drejtorati për Buxhet dhe Financa të bëjë ekzekutimin e pagesës në shumë prej 34,735.00 (tridhjetë katër mijë e shtatëqind e tridhjetë e pesë euro), konform Vendimit të Kuvendit të Komunës për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e klubeve sportive 15Nr.400-16852 i datës 17.04.2020, për të cilat klube sportive për shkak të rrethanave jo të zakonshme si pasojë e përhapjes së pandemisë Covid - 19 në nivel global nuk kanë mundur të zhvillohen, procedurat e shpalljes publike për aplikim.

Klubet sportive që do të mbështeten financiarisht janë si vijon:

Nr.	Emri i klubit sportiv	Shuma
1.	Klubi i basketbollit "Lipjani" Lipjan	7,185.00 €
2.	Klubi futbollistik "Arbëria" Dobrajë e Madhe	7,050.00 €
3.	Klubi futbollistik "ULPIANA-1926" Lipjan	6,550.00 €
4.	Klubi volejbollistik "ULPIANA" femrat	2,550.00 €
5.	Klubi i atletikës "Blinaja" Lipjan	1,000.00 €
6.	Klubi hendbollistik "ULPIANA" femrat	1,050.00 €
7.	Klubi hendbollistik "ULPIANA" meshkujt	1,050.00 €
8.	Klubi i shahut "ULPIANA"	850 €
9.	Klubi i basketbollit "ULPIANA 2002"	800 €
10.	Klubi futbollistik "MINATORI"	3,550.00 €
11.	Klubi volejbollistik "ULPIANA" meshkujt	1,550.00 €
12.	Klubi volejbollistik "SHPELLA E MERMERTË"	1,550.00 €
	gjithsej	34,735.00

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2020, pozicionet buxhetore - subvencionet e planifikuara për Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 3

Të drejtat dhe obligimet në mes të Komunës dhe Klubeve Sportive do të përcaktohen më detajisht në Kontratën e cila do të lidhet në mes Kryetarit të Komunës dhe secilit klub sportiv veq e veq.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

1Nr. 400-20523

Lipjan, më 04.06.2020

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

